

GREEN COAST SH.P.K.

RRUGA "TISH DAIJA", KOMPLEKSI KIKA 2, GODINA 3, KATI 1., TIRANE, SHQIPËRI

L41329038D

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 29.07.2025, në orën 10.00, në selinë e Shoqërisë **Green Coast Sh.p.k.** (më tej referuar si "Shoqëria"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

- **Shoqëria Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Regjistrit Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K72223031K, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Edlira MUKA, shtetase shqiptar, lindur më datë 03.02.1983, në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me Nr. 0342771384 (dhe me nr. Personal: I35203147R), madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, (këtu e në vijim referuar si "**Ortaku i Vetëm**"),

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Z. Bers Hado, këshilltar ligjor i shoqërisë, i cili pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është **5,126,755,328.00 LEK (pesë miliard e njëqind e njëzete e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e njëzet e tetë lekë)**.

Në kushtet kur veprimtaria e Shoqërisë ka përformuar kënaqshëm dhe situata financiare është në përputhje me pritshmëritë, është propozuar nga ana e Ortakut të Vetëm zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë në vlerën prej 2,000,000 Euro (dy milion euro), e barasvlereshme me shumën në LEK 195,080,000 (Njëqind e nentëdhjetë e pesë milion e tetëdhjetë mijë lekë) sipas kursit të këmbimit 97.54 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 29.07.2025.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Miratimin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë me vlerën 2,000,000 Euro (dy milion euro), e barasvlereshme me shumën në LEK 195,080,000 (Njëqind e nentëdhjetë e pesë milion e tetëdhjetë mijë lekë) sipas kursit të këmbimit 97.54 të publikuar nga Banka e Shqipërisë në datë 29.07.2025.
- B. Si rezultat i miratimit të Zvogëlimit të Kapitalit sipas pikave (A) dhe (B) më sipër, kapitali i Shoqërisë nga 5,126,755,328.00 LEK (pesë miliard e njëqind e njëzete e gjashtë milion e shtatëqind e pesëdhjetë


e pesë mijë e treqind e njëzet e tetë lekë), bëhet 4,931,675,328.00 LEK (Katër miliardë, nëntëqind e tridhjetë e një milionë, e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë, e treqind e njëzet e tetë lekë).

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 10.30.

Ky procesverbal i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Green Coast" sh.p.k mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.


**ASAMBLEE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË
GREEN COAST SH.P.K.**

KRYETARI


Znj. Edlira MUKA



SEKRETARI


Z. Bers Hado

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L41329038D
2. Data e Regjistrimit	29/01/2014
3. Emri i Subjektit	GREEN COAST
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	29/01/2014
6. Kohëzgjatja	Nga: 29/01/2014
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Tish Daija, kompleksi Kika 2, godina 3, kati 1.
8. Kapitali	5.126.755.328,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Objekti paresor i veprimtarise se shoqerise eshte Projektimi, ndertimi, venia ne shfrytezim e nje kompleksi turistik, nje strukture hotelerie dhe e objekteve turistike sezonale ne Palase. Shitja e objekteve me destinacion rezidencial veror dhe/ose administrimi i tyre, si dhe ofrimi i sherbimeve te hotelieri-turizmit ne zone e Palases, si dhe cdo veprimtari tjeter plotesuese, qe lidhet direkt ose indirekt me vepimtarine e siperpermendur. Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose bleje/perfitoje direkt ose indirekt pjesemarrje, ne shoqeri, ndermarrje, agjenci apo siper marrje te tjera, te cilat kane fushe veprimtarie te ngjashme. Gjithashtu, shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo opercion tjeter qe ka te beje me pronen e paluajtshme, te luajtshme, cdo veprim apo operacion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te Shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe te mos alterojne objektin paresor te Shoqerise.
10. Administratori/ët	Armando Alicanaj
10.1 Afati i emërimit	Nga: 06/07/2025 Deri: 05/07/2028
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore	11. 2 Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë.
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në

përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, datë 14 Prill 2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme. Për më shumë qartësi, Administratori/ët përveç kompetencave të parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare përmes këtij Statuti, ka të drejtë: a. të kryejë blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta për mallra, punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër e cila nuk është nën përgjegjësinë direkte të Asamblesë së Përgjithshme deri në vlerën e barabartë me 250.000 EUR (dyqind e pesëdhjetë mijë Euro), për çdo transaksion apo në agregat. Mbi këtë vlerë dhe deri në 1.000.000 EUR (një milion Euro), do të merret miratimi i Zëvendës Presidentit të Sektorit të Pasurive të Paluajtshme;

b. ka të drejtë të kryejë të gjitha shitjet e njësive/objekteve të banimit dhe/ose shërbimit dhe/ose njësi/objekte të cilësdo natyre qoftë tek klientët e interesuar, në te cilat Shoqëria rezulton të jetë investitore ose përfituese si pronare trualli, pa ju nënshtruar kufizimeve të cilësuar në pikën a. më sipër; c. hartojë, formalizojë dhe komunikojë procedurat e brendshme, urdhrat dhe udhëzimet që duhet të dalin në zbatim të këtij Statutit dhe/ose rregulloreve të brendshme të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. d. të miratojë dhe lidhë marrëveshje sipas së cilës miratohet vendosja e barrëve siguroese mbi të drejtat ose barrë hipotekore mbi pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të Shoqërisë apo ende në proces zhvillimi nga Shoqëria, në favor të bankave të nivelit të dytë, për të garantuar pagesën e detyrimeve monetare nga ana e klientëve që kanë blerë nga shoqëria, po këto pasuri të paluajtshme nëpërmjet financimit nga bankat e nivelit të dytë. 11.3

Për të shmangur çdo paqartësi dhe ambiguitet në lidhje me kompetencat e Administratorit në raport me institucionet bankare në Republikën e Shqipërisë dhe pa përjashtuar sa më sipër përcaktuar në këtë Statut, cilësohet specifikisht se Administratori mund: a. të veprojë i vetëm në emër e për llogari të Shoqërisë, lidhur me kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme me qëllim hapjen/mbylljen e llogarive bankare të Shoqërisë pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktivizimin, shfrytëzimin ose çaktivizimin nga ana e Shoqërisë e të gjitha shërbimeve specifike të ofruara nga banka/at lidhur me llogaritë bankare të hapura prej tij; b.

të autorizojë i vetëm caktimin/heqjen e personave që kanë të drejta të përdorin dhe të kryejnë veprime nëpërmjet sistemeve të ‘online banking’ pranë bankave të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë; c. të kryejë çfarëdolloj

	veprimi tjetër që lidhet me administrimin e zakonshëm të përditshëm të Shoqërisë pranë çdo banke të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, që nuk bie ndesh apo kufizohet me vendime të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë apo procedura të tjera të caktuara në këtë Statut apo në ligj. d. të kryejë veprimet e nevojshme në institucionet bankare përkatëse për pajisjen me kartë/ta krediti biznesi për nevojat e përditshme të Shoqërisë. Administrator/ët mund të vendosin që më shumë se një person nga Shoqëria të pajiset me kartë krediti biznesi. Në çdo rast, limiti i kreditimit në agregat do të jetë i kufizuar në vlerën maksimale prej 10,000 (dhjetë mijë) Euro. 11.4 Administratori/ët mund të emërojë/në përfaqësues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose ky Statut.	
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	GRANT THORNTON	
12.1 Afati i emërimit	Nga:	Deri:
13. Ortakët	Balfin - Balkan Finance Investment Group	
13.1 Vlera e kapitalit	Para:	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	5.126.755.328,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	1,00	
	100,00	
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Vlore Himare PALASE Plazhi Dhraleos, Himare, Nr. Pasurie 68/120, Vol. 2, Faqe 6 dhe Pasuria 68/121, Vol. 2, Faqe 7, ZK. 1739 Vlore Himare DHERMI Rruga Nacionale Dhermi-Vlore, ne vendin e quajtur "AJO NIKOLLA, Dhrale dhe me Nr.Pasurise :ZK 1481-1739	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: GREEN COAST E-Mail: a.alicanaj@greencoast.al Telefon: 0692094001	
16. Statusi:	Aktiv	

Datë: 29/07/2025

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
 (i nëpunësit të sportelit)

